



BPArL **UNIVERSITETI AAB**  
**AAB UNIVERSITY**

Magjistralja Prishtinë - Fushe Kosovë  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel&fax: +381 (0)38 601 019  
+381 (0)38 601 020  
e-mail: [info@universitetaab.com](mailto:info@universitetaab.com)  
web: [www.universitetaab.com](http://www.universitetaab.com)

---

# Rregullore për sistemin tutorial në Universitetin AAB



#### Neni 1

Me këtë Rregullore synohet të rregullohet puna e sistemit të tutorimit në Universitetin AAB.

#### Neni 2

Qëllimi i sistemit të tutorimit është që të krijojë kushte për:

- a) Vendosjen e linjës së drejtpërdrejtë studentit dhe profesorit;
- b) Integrimi i studentit në ambientin e Universitetit;
- c) Krijimi i klimës për të arritura më të larta të studentëve dhe ngritja e kualitetit të cilësisë së mësimi;

#### Neni 3

Veprimtaria tutoriale mund të kryhet nga profesori dhe studenti

#### Neni 4

Tutor mund të jetë secili student i rregullt apo jo i rregullt (pa shkëputje nga puna) i cili së paku është i regjistruar në vitin e dytë akademik dhe ka notë mesatare mbi nëntë (9.0) dhe i cili aplikon para Komisionit për zgjedhjen e tutorit.

#### Neni 5

Mandati i studentit tutor zgjat një vit me mundësi të përsëritjes.

#### Neni 6

Qëllimi i studentëve tutorë është si vijon:

- a) Studentët të cilët i udhëheqë (mbikëqyrë), t'i informojë me të gjitha aspektet ligjore dhe aspektet tjera dhe, veçanërisht rreth të drejtave dhe detyrave të studentit;
- b) Që studentët e udhëhequr t'i këshillojnë në tejkalimin e vështirësive në procesin edukativ;
- c) Të mbajë evidencë për punën me studentët e mbikëqyrur.

#### Neni 7

Studenti tutor është i obliguar të raportojë çdo muaj tek Komisioni për tutor për punën e tij dhe për rezultatet e arritura.

Raporti përpilohet me shkrim dhe në rastet kur e kërkon Komisioni të njëjtin edhe e prezanton edhe me gojë.

#### Neni 8

Profesor tutor mund të jetë çdo mësimdhënës i angazhuar në Universitetin AAB

#### Neni 9

Mandati i profesorit tutor zgjat prej fillimit të semestrit të parë deri në përfundim të studimeve të studentëve që i tutorin (mbikëqyrë).



#### Neni 10

Qëllimi i mësimdhënësve tutorë është që të komunikojë direkt ose në mënyrë elektronike me studentin dhe ta këshillojë atë për të gjitha aspektet në veçanti për programet e caktuara.

#### Neni 11

Mësimdhënësi tutor po ashtu raporton çdo muaj tek Komisioni për tutor rreth progresit të studentëve të tutoruar.

#### Neni 12

Procesi tutorial në Universitetin AAB organizohet prej Komisionit Tutorial.

#### Neni 13

Qëllimet e këtij Komisioni janë si vijon:

- a) Në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve, Komisioni në fillim të çdo viti akademik paraqet numrin e domosdoshëm të mësimdhënësve dhe studentëve tutorë.;
- b) Organizon përgatitjen profesionale të mësimdhënësve dhe studentëve tutorë;
- c) Komisioni raporton me shkrim për aktivitetin e tij në fillim dhe në fund të çdo semestri tek Rektori i Universitetit.

#### Neni 14

Rektori i Universitetit obligohet që të informojë Senatin në mënyrë të rregullt për aktivitetin e Komisionit tutorial dhe sistemin tutorial në përgjithësi.

#### Neni 15

Në fund të çdo viti akademik, studenti tutor merr certifikatë për aktivitetin e tij në sistemin tutorial. Certifikata po ashtu është pjesë e diplomës në Universitet, nëse Komisioni tutorial e vlerëson atë si tutor të suksesshëm.

#### Neni 16

Tutorët mësimdhënës dhe student duhet të stimulohen për aktivitetin e tyre. Pjesa financiare e kundërshtëpërblimit rregullohet me një rregullore apo tarifë të veçantë të cilën e përpilon Komisioni Tutorial në pajtueshmëri me Senatin dhe duke siguruar pëlqimin e Bordit.

#### Neni 17

Komisioni tutorial përbëhet nga këta anëtarë:  
Dekani i Fakultetit  
Prorektori për studentë dhe  
Shefi i Zyrës për Cilësi të Mësimi.

#### Neni 18

Komisioni zgjedh kryetarin e tij brenda anëtarëve të vet.



Neni 19

Komisioni tutorial për punën e tij i përgjigjet Rektorit të Universitetit. Të paktën në fillim ose mbarim të çdo semestri.

Neni 20

Komisioni vendimet e tij i merr me shumicë votash.

Neni 21

Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Rektori i Universitetit

Rektori i Universitetit  
Urosh Lipuscek, PhD

---

Prishtinë  
25.09.2008